



Ri-Lajmërim Gare (Procedurë e Negociuar)

Për projektimin dhe supervizimin e rehabilitimit dhe supervizimin e objektit
Urdhër blerje nr. QDA 012/23

RFP QDA/TWIST/OCT/2023/PN 012

“Qendra Durrësi Aktiv” është një organizatë joqeveritare e themeluar më 15 maj 2019. Ajo ushtron aktivitet jofitimprurës me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve përmes ndryshimeve ekonomike, politike, mjedisore dhe sociale. Zyra qendrore e administrative e QDA ndodhet në **Durrës, Rruga "Epikadeve", pallati 1047 Durrës, Albania.**

Nëpërmjet kësaj mundësie subjekti synon të nisë një garë për projektimin dhe supervizimin për rehabilitimin e objektit Objekti – “Apartament” me sipërfaqe 67.2 m², është i pozicionuar në zonën e plazhit të Durrësit në afërsi të hotel “Florida”.

Titulli i kontratës

Hartimin e projekteve dhe supervizimin e punimeve.

Vendndodhja

Plazhit të Durrësit në afërsi të hotel “Florida”, Durrës.

Autoriteti Kontraktues

Qendra Durrësi Aktiv

1.- Specifikime të kontratës

Hartimin e projekteve dhe supervizimin e punimeve për objektin 67.2 metra katror e ndarë në 3 dhoma:

- Hartim dhe zbatim i projektit rikonstruksionit muraturë e brendëshme+Preventiv
- Hartim dhe zbatim i projektit elektrik (të thjeshtuar)+Preventiv
- Hartim dhe zbatim i projektit hidrosanitar+Preventiv
- Hartim dhe zbatim i projektit te arredimit te ambienteve te brendëshme+Preventiv
- Hartim dhe zbatim i projektit mekanik (kundra zjarrit) +Preventiv

Sipas dokumentave bashkëngjitur, në CD, të projekteve të mësipërme.

2.- Kushtet për pjesëmarrje

2.1.- Takimet informuese dhe vizita në objektin i cili do të rikonstruktohet



Një takim informues dhe një vizitë në pronësinë ku do të bëhet për projektimin dhe supervizimin për rehabilitimin e objektit Objekti – “Apartament”, do të organizohen me secilin prej pjesëmarrësve.

Datat për të vizituar vendin e ndërtimit janë: 20 Tetor 2023 (orari për t’u përcaktuar).

2.2.- Vlefshmëria e ofertës.

Oferta është e vlefshme për një periudhë prej 15 ditësh pas datës së skadencës për dorëzimin e ofertave.

2.3.- Periudha e zbatimit të punës.

E gjithë puna e projektimit për rehabilitimin dhe supervizimin e rikonstruksionit të objektit duhet të përfundohet brenda dhe jo përtej 1.5 muajve nga data e fillimit të punës së entit të nën kontraktuar nga firma projektuese.

2.4.- Gjuha e paraqitjes së ofertave

Ofertat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe.

3.- Dokumentacioni i kërkuar

3.1.- Legjimiteti për pjesëmarrje nw garë:

- A. Çertifikatë legjimitimiteti.
- B. Fotokopia e “Liçensës për ushtrimin e aktivitetit të sipërmarrjes” e vlefshme ose çertifikatë ekuivalent.
- C. Fotokopia e “Çertifikatës së themelimit” e vlefshme ose dokumentacion ekuivalent.
- D. Deklaratë e derdhjes së rregullt të taksave.
- E. Fotokopia e “NIPT”.

Në rast se firma nuk paraqet një prej dokumentave të kërkuara më sipër, ajo do të përjashtohet automatikisht nga gara.

3.2.- Informacione shtesë:

- A. Informacione të përgjithshme: Curriculum vitae i firmës;
- B. Eksperiencë e përgjithshme: punët e fundit të kryera në fushën civile në tre vitet e fundit;
- C. Personeli: CV dhe fotokopje e kualifikimit dhe të eksperiencës së firmës projektuese dhe supervizuese;
- E. Deklaratë bankare: vërtetim që firma nuk është në debi
- F. Ekstrakt gjygjësor: informacione që i përkasin çdo lloj çështjeje ligjore dhe procese pezull të firmës gjatë 5 viteve të fundit.



3.3.- Kronograma kohore e fazave të ndryshme të punës sipas planit të rënë në dakordësi

3.4.- Oferta financiare, duhet të jetë e detajuar: përshkrim i projekteve, çmimi për projekt, vlera totale përfshirë TVSH (në rastin e importeve të detajuara jo qartësisht do të merret e mirëqenë që TVSH është e përfshirë). Të gjitha çmimet duhet të shprehen në Lek.

Në ofertën financiare duhet të përfshihen shpenzimeve për marrjen e autorizimeve pranë zyrave kompetente për lejen e ndërtimit.

Çdo faqe e dokumentit duhet të firmoset nga personi i autorizuar.
Zarfi me dokumentacionin përkatës të kërkuar duhet të dërgohet në:

**Qendra Durrësi Aktiv
Rr. Rruga "Epikadeve", pallati 1047 Durres, Albania.
Durrës- SHQIPËRI**

Zarfi duhet të tregojë anash të adresës vetëm kodin e mëposhtëm të identifikimit
RFP QDA/TWIST/OCT/2023/PN 012

4.- Kriteret e fitimit të garës

A- Informacione shtesë

B- Kronograma kohore kohore e fazave të ndryshme të punës sipas planit të rënë në dakordësi

C- Çmimi.

Oferta më e mirë do të gjykohet nga Komiteti i Garave në brendësi të QDA.

QDA ka të drejtën të mos shpallë asnjë fitues midis firmave që paraqiten ose ka të drejtën të shpallë fituese edhe një firmë të vetme që paraqitet.

5.- Gara për tenderim

5.1.- Dosieri

Pjesëmarrësit duhet të paraqesin ofertën e tyre duke ndjekur standardet dhe kërkesat eksplicite të pranishme në dosierin e dorëzuar të Garës së tenderimit.

Pjesëmarrësit që kanë dyshime apo pyetje lidhur me garën mund të paraqesin kërkesën e shkruar për sqarime drejtuar Znj. Migena Nako pranë adresës së sipërpërmendur brenda dhe jo më tej se 5 ditë nga data e paraqitjes së ofertave. Këto kërkesa do të marrin përgjigje brenda dhe jo më tej se 2 ditë para datës së dorëzimit të ofertës.

Të gjitha shpenzimet për përgatitjen e dosierin janë në ngarkim të firmës që paraqet ofertën. Firmat duhet të paraqesin ofertën e tyre të shprehur në Lek ose Euro duke përfshirë TVSH në zarf të mbyllur (në rast se ajo nuk është qartësisht e detajuar do të nënkuptohet se TVSH është e përfshirë).

5.2.- Kohërat e dorëzimit të ofertave



Ofertat duhet të dorëzohen brenda dhe jo më tej së ditën **e premte 3 nëntor 2023 në orën 14:00**

Çdo lloj oferte e marrë pas këtij afati kohor nuk do të merret në konsideratë.

5.3.- Hapja e ofertave

Hapja e ofertave do të ndodhë ditën **e premte 3 nëntor 2023 në orën 16:00**

5.4.- Kontrata me firmën fituese

QDA do t'i paraqesë me shkrim pjesëmarrësve rezultatet e garës. Lajmërimi do t'u dërgohet të gjitha firmave pjesëmarrësve.

QDA do të firmosë një kontratë me firmën që do të rezultojë fituese duke iu referuar vlerësimit të vendosur sipas "kritereve për fitimin e garës".

5.5.- Modaliteti i pagesës

5.5.1 Hartimin e projekteve sipas pikës 1 Specifikime të kontratës;

a) Paguhet një parapagesë prej 10% të shumës në momentin e nënshkrimit të kontratës.

a) Pagesë prej 60% me dorëzimin e drafteve për të gjitha projektet dhe preventivat e përmendur në pikën 1

c) Pageese prej 30% për dorëzimin përfundimtarë të projekteve dhe preventivave paraprak të orientuar në çmimet e tregut dhe referencës të cilët do të shërbejnë më pas për ti tenderuar dhe përzgjedhur entin që do të zbatojë punimet.

5.5.2 Supervizimin e punimeve në objekt sipas projekteve dhe preventivave të paraqitura nga enti i kontraktuar

a) Paguhet një parapagesë prej 10% të shumës në momentin e nënshkrimit të kontratës.

a) Pagesë mujore ne baze te avancimit te punimeve vërtetuar nga situacionet e punimeve nga enti i kontraktuar.

5.6.- Klauzolë arbitrare

Në rast mosmarrëveshesh midis palëve mbi detyrimet sipas nënshkrimit të kontratës që nuk mund të zgjidhen në rrugë informale, do të themelohet një kolegji arbitrar në Shqipëri i përbërë nga dy arbitra, të përzgjedhur secili për secilën palë në kauze. Në rastet kur dy arbitrat nuk do të arrijnë në një marrëveshje, mosmarrëveshesh do të zgjidhet në mënyrë të përvokueshme nga një arbitër i vetëm "super partës" i emëruar nga dy arbitrat e palëve. Arbitrat e palëve ose arbitri i vetëm "super partes" duhet në fund të vendosin në përpjesëtim edhe për se si do të ndahen shpenzimet e arbitrarizmit.

Arbitrat e palëve ose arbitri i vetëm "super partës", me konsensusin e palëve, mund të vendosin, herë pas here, të zgjasin kohërat e dorëzimit të asaj çka është rënë dakord në kontratën e firmosur nga të dy palët.

Durrës, 23 Tetor 2023

Logjistika QDA
Migena Nako